POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Fitonte 10 mijë euro për koncert, Luiz Ejli mëzohet nga froni! Divorci pasuron Xhensila Myrtezajn, zbulohen tarifat e VIP-ave për vetëm dhe kush kryeson listën e më të paguarve

2 Historika në 'Paris 2024'/ Mundësi Chermen Valiev i jep Shqipërisë medaljen e parë Olimpike

3 Kush është shqiptari Armando Pacani, i arrestuar në Dubai për zarfa kokaine nga Brazili? I kamuflluar si CEO i një kompanie, në Skyficc ishte 'Albanes', 'Forbes' dhe 'Globe'

4 Paris 2024/ Mundësi Valiev fitoi medaljen historike për Shqipërinë, Rama: Një lajm që fët shumë! Komitetit për Olimpik ka rënduar

5 PROFILI/ Kush është Chermen Valiev, rusi nga Osetia e Veriut që i dha Shqipërisë medaljen e parë Olimpike në histori

Kronikë

Parandalohet krimi në familje në Durrës, 53-vjeçari përleshet me 2 vëllezërit e tij, njëri plagoset! I gjenden armë e silenciator, të tre në pranga (Emrat)

Andrea Përkeqi sulmoi me thikë dy familjarët pas një konflikti, më parë u shpoi dhe gomat e furgonit. Hetohen motivet, arrestohen të tre. Sekuestrohen 2 pistoleta dhe municion, ngrihen katër akuza

Pamje nga arrestimi i një prej vëllezërve Përkeqi, në Durrës

Redaksia
10 Gusht, 14:58 | **Përditësimi: 10 Gusht, 15:10**

Share

Durrës- Një krim në familje u parandalua sot (10 Gusht) në qytetin e Durrësit nga policia, teksa 3 vëllezër janë përleshur mes tyre me armë të ftohta dhe sende të forta, pas një grindjeje me motive të dobëta.

Ngjarja ndodhi në zonën e Hamallajt dhe shkaktoi panik, teksa dinamika e krimit fillimisht pati një grindje mes familjeve që i ndante vetëm gardhi dhe më tej i dyshuari 53-vjeçar Andrea Përkeqi fillimisht ka shpuar me thikë gomat e furgonit dhe më tej sulmoi dy vëllezërit e tjerë.

Për pasojë një prej tyre mori plagë në dorë. Policia e sinjalizuar mbërriti në vendngjarje dhe parandaloi përshkallëzimin e mëtejshëm, duke arrestuar edhe të dyshuarit për vepra të ndryshme penale. Dy të ndaluarit e tjerë janë Luan dhe Ylli Përkeqi, respektivisht 49 dhe 43 vjeç. Si prova materiale janë sekuestruar edhe dy armë zjarri.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Durrës/ Tentoi të digjte mbetjet bujqësore në tokën e tij, vdes i asfiksuar nga zjarri 75-vjeçari (Emri)

"Nga veprimet e shpejta rezultoi se gjatë një konflikti të çastit, për motive të dobëta, në oborrin e përbashkët të banesave të tyre, njëri prej vëllezërve, shtetasi A. P., (Andrea Përkeqi), ka dëmtuar me mjet prerës thikë gomat e një automjeti tip furgon, dhe më pas është konfliktuar fizikisht me dy vëllezërit e tij, shtetasit L. P. dhe Y. P, duke përdorur sende të forta dhe mjet prerës, ku si pasojë ka mbetur i dëmtuar në dorë shtetasi Y. P., jashtë rrezikut për jetën", thuhet në njoftimin zyrtar.

Ndërhyrja e uniformave blu i çoi të dyshuarit në pranga dhe parandaloi përshkallëzimin.

Burime zyrtare sqaruan se "gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e të dyshuarit, u gjetën dhe sekuestruan dy armë zjarri pistoleta, katër karikatorë për pistoletat, një silenciator i pamontuar dhe fishekë luftarakë". Gjithashtu, u sekuestrua dhe mjeti prerës, thikë, i përdorur gjatë konfliktit.

Veprimet u kryen nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve, teksa dosja i kaloi prokurorisë vendore, ku po merren në pyetje edhe tre familjarët e dyshuar për shkaqet e ngjarjes dramatike.

Akuzat ndaj tyre janë; "dhuna në familje", "mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municioneve", "prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "shkatërrim prone" për të dyshuarin Andrea Përkeqi dhe "dhuna në familje" për dy të tjerët.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: krim ne familje | Durres

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh.com]

Sondazhi i ditës:
Si po përballohet situata e krijuar nga zjarret në vend?

Mirë | Keq | Nuk e di

Lajme të tjera

Vrau babanë, zbardhet dëshmia e djalit: Ishte xheloz dhe me probleme mendore, pashë si nëna dha frymën e fundit!
10 Gusht, 13:20

Vodhën pikën e këmbimit valutor në Shkodër, dy 'ukrainasit' përdorën të njëjtën skemë në Durrës! Policia në kërkim të 2 hajdutëve profesionistë (FOTO)
10 Gusht, 12:27

Tentoi të grabiste turistin italian me thikë në plazhin e Durrësit, arrestohet 20-vjeçari nga Bulqiza. Ishte rezident në Itali (Emri)
10 Gusht, 12:15

Shpërthen autoboti në autostradën Tiranë-Durrës, plagosen dy punonjës të 'Gega Oil'! Mjeti po shkarkonte naftë në pikën e karburantit
9 Gusht, 15:24

Nuk ktheu makinën e marrë me qira dhe mashtroi, arrestohet 24-vjeçari në Durrës! Dëshmia: Ma bllokuan në Greqi (Emri)
9 Gusht, 11:00

Pajisje jetëshpëtuese në bregdetin e Golemit, ministrja Koçiu: Bashkëpunim mes institucioneve për rritjen e sigurisë në plazhe
8 Gusht, 13:06

Merrnin para për vendparkimin publik, 2 të arrestuar në Durrës! Në pranga dhe një 45 vjeçar për plagosje
8 Gusht, 09:41

Ceremonia përkujtimore në 15-vjetorin e rënies në krye të detyrës të 4 Dëshmorëve të Atdheut, ministri Ervin Hoxha: Falë sakrificës së tyre gëzojmë të ardhme të sigurt
7 Gusht, 15:29

'Balkan Bazar' dhuron spektakël në Durrës, këngë shqiptare me ritmet e muzikës Rock

Aldo Mustafa

7 Gusht, 14:19

Ankorohen në Durrës dy superjahtet e themeluesit të "WhatsApp", Jan Koum
7 Gusht, 13:45

Durrës/ 45-vjeçari plagos me thikë pas sherrit pronarin e një servisi! Autori arrestohet pranë shtëpisë, dyshohet me probleme mendore
7 Gusht, 13:44

Durrës/ Po çonte fëmijën në spital, makina kalon me semafor të kuq! Përplaset me automjete të tjera
6 Gusht, 13:09

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje